



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2480/ 10 prot.

Datë 04/11/2025

V E N D I M
Nr. 1603/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04/11/2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1532/2025, datë 27.10.2025 për procedurën e prokurimit “Proçedurë e hapur” me Nr. REF-53029-07-01-2025, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës lidhëse të fshatit Dragu dhe fshati Koçaj, NjA Fushë Bulqizë” me fond limit: 20.500.000 (njëzet milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.

Ankimues: Operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h (degë e shoqërisë mëmë RSM COMPANY) SHPK me NIPT L04803001U, me adresë: Rruga “Xhorxhi Martini”, Nr. 20, Godinë 11-katëshe, Shk. 2, Kati. 7, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Bulqizë.
Adresë: Lagjia “Minatori” Bulqizë.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “K. Turja” SHPK me NIPT K81314014A, me adresë: Ura Gjoles, Budull, Bubq, Durrës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e

Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 27.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1532/2025, ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-53029-07-01-2025, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës lidhëse të fshatit Dragu dhe fshati Koçaj, NjA Fushë Bulqizë” me fond limit: 20.500.000 (njëzet milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.*
2. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h në baze të konstatimeve të shprehurane këtë vendim.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 5936 prot., datë 30.10.2025, protokolluar me tonën nr. 2480/7 prot., datë 03.11.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Bulqizë., informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1532/2025, datë 27.10.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-53029-07-01-2025, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës lidhëse të fshatit Dragu dhe fshati Koçaj, NjA Fushë Bulqizë” me fond limit: 20.500.000 (njëzet milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 5936 prot., datë 30.10.2025, protokolluar me tonën nr. 2480/7 prot., datë 03.11.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Bulqizë., informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1532/2025, datë 27.10.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-53029-07-01-2025, me objekt “Sistemi asfaltim i rrugës lidhëse të fshatit Dragu dhe fshati Koçaj, NjA Fushë Bulqizë” me fond limit: 20.500.000 (njëzet milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor nëpërmjet shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik praktikën për zbatimin e vendimit nr. 1532/2025 datë 27.10.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës duke evidentuar në mënyrë të qartë arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 1532/2025, datë 27.11.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-53029-07-01-2025, me objekt “Sistemi asfaltim i rrugës lidhëse të fshatit Dragu dhe fshati Koçaj, NjA Fushë Bulqizë” me fond limit: 20.500.000 (njëzet milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

